



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 545 prot.

Tiranë, më 29. 04. 2020

V E N D I M

Nr. 41, Datë 29. 04. 2020

Mbështetur në ligjin nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa me nr. 146 regjistri, datë 13.11.2019, e subjektit ankues, R. G., kundër Universitetit të Tiranës, Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, Departamentit të Historisë dhe Komisionit¹ Ad Hoc i ngritur me Vendimin Nr. 39, datë 26.06.2019 në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, me pretendimin për diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar njoftimit të bërë në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik, në Buletinin nr. 20, datë 20.05.2019, për një vend të lirë pune për personel akademik në Departamentin e Historisë, në Kategorinë Lektor pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës, ankuesi më datë 03.06.2019 ka paraqitur aplikimin e tij, pranë zyrës së Burimeve Njerëzore.

Në vijim ai shprehet se me vendimin nr. 39, datë 24.06.2019, nga ana e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, është ngritur komisioni ad hoc, për konkursin personel akademik të kategorisë “Lektor” pranë Departamentit të Historisë. Më datë 03.07.2019, komisioni i ngritur, ka zhvilluar intervistën me ankuesin dhe kandidatët e tjerë, ku pas këtij procesi janë përzgjedhur të kalojnë në votim kandidatja E. K. dhe ankuesi. Në përfundim të procesit të vlerësimit të kandidaturave, Komisioni Ad hoc shpalli fituese znj. E. K. Lidhur me këtë, sipas ankuesit më datë 29.07.2019, ka marrë dijeni nëpërmjet shpalljes së bërë publike në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës, pasi asnjë prej strukturave përgjegjëse nuk e ka vënë në dijeni më parë.

¹ Shtetasve: P. N., M. Gj., E. H., E. B. dhe Ç. D.

Sipas ankuesit, kriteri i parë i përcaktuar me Vendimin nr. 67, datë 13.05.2019 *“Për miratimin e kritereve që duhet të plotësojnë kandidatët për një vend pune personel akademik”*, citon se kandidati: *“Të jetë i diplomuar në ciklin e parë të studimeve në degën Histori pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë UT, ose në Drejtësi, në Fakultetin e Drejtësisë të UT –së”*.

R. G. zotëron dy Diploma në Histori: Diplomë të ciklit të parë në Degën e Historisë, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, me mesatare 9.9, Diplomë të Nivelit të Dytë po në Histori në UT, Fakulteti Histori Filologji, me notë mesatare 9.9, si dhe një diplomë të tretë bachelor 4 vjeçar në Drejtësi, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, me mesatare 8.5.

Referuar provave të vëna në dispozicion nga subjekti ankues, Komisioni ad hoc, në vlerësimin e kriterit të parë, citon se kandidati Prof. Dr. R. G. ka përfunduar studimet e ciklit të parë në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe jo në Universitetin e Tiranës.

Përsa më sipër, ankuesi pretendon se ky kriter, i cili e ka përjashtuar, çënon rëndë parimin e barazisë. Gjithashtu, ai sqaron se në mënyrë të qëllimshme Komisioni ad hoc, nuk ka vlerësuar, studimet e nivelin e dytë dhe të tretë në Departamentin e Historisë së Fakultetit Histori-Filologji UT-së.

Referuar kriterit të dytë të përcaktuar në Vendimin nr. 67 datë 13.05.2019 *“Për miratimin e kritereve që duhet të plotësojnë kandidatët për një vend pune personel akademik”*, ankuesi sqaron se ai kërkon që kandidati duhet të ketë notën mesatare të studimeve të ciklit të parë mbi 9.

Nisur nga kjo, komisioni ad hoc, në vlerësimin e këtij kriteri për ankuesin, i është referuar Diplomës së tretë, plotësuese, asaj në Drejtësi, si studime të ciklit të parë, Diplomë e cila mban notën mesatare 8.5, duke përjashtuar nga vlerësimi dy diplomat pararendëse në Histori.

Sipas ankuesit, vlerësimi i këtij kriteri, nga ana e komisionit ad hoc, është në shkelje të rëndë, sepse komisioni nuk i është referuar diplomës në degën e Historisë, e cila mban notën mesatare 9.9, por diplomës në drejtësi. Kriteri i parë përcakton dy mundësi: 1. Studime Bachelor ne Degën Histori; ose 2. Studime Bachelor në Drejtësi. Pra, ankuesi vlerëson se komisioni ka çënuar rëndë përcaktimet e kriterit të parë, duke shkelur parashikimet e Vendimit nr. 67 datë 13.05.2019 *“Për miratimin e kritereve që duhet të plotësojnë kandidatët për një vend pune personel akademik”*.

Gjithashtu, sipas ankuesit është çënuar parimi i transparencës, përcaktuar në statutin e Universitetit të Tiranës. Mbajtja e fshehtë dhe jo transparente e notës mesatare të kandidatës fituese, çënon rëndë parimin e transparencës, duke mos zhvilluar një konkurs të drejtë, transparent dhe të paanshëm. Përjashtimi i tij dhe favorizimi i kandidatës E. K., sipas ankuesit përbën diskriminim pasi promovohet kandidati me gradë me të ulët, dhe përjashtohet kandidati me titullin Profesor.

Përsa më lart, ankuesi sqaron se ai është skualifikuar pa asnjë shkak të ligjshëm nga ana e Komisionit të Vlerësimit, duke u trajtuar kështu në mënyrë të pabarabartë dhe diskriminuese për shkak të gjendjes arsimore.

Në përfundim të ankesës, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit për shkak të gjendjes arsimore të tij nga ana e Rektorit të Universitetit të Tiranës, Fakultetit të Histori Filologjisë së UT-së dhe anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit Ad hoc. Gjithashtu, ka kërkuar:

- Pezullimin e efekteve të kontratës së punës mes Universitetit të Tiranës dhe kandidatës fituese,
- Të shqyrtohet mundësia për të vlerësuar nëse në marrjen e këtij vendimi ka pasur arsye të paragjyqimeve të prejardhjes krahinore dhe përkatësisë politike.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës Nr. 146 regjistri, datë 13.11.2019, të R. G. u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010

² Prejardhja krahinore

³ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e tij.

- Me anë të shkresës Nr. 1322/3 prot., datë 21.11.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është drejtuar subjekteve, ku i ka kërkuar informacion lidhur me pretendimet për diskriminim, të subjektit ankues.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, me shkresën⁴ Nr. 858/9 prot., datë 25.11.2019, përcolli argumentat e Komisionit Ad Hoc dhe vuri në dispozicion të KMD-së informacion lidhur me pretendimet e palës ankuese, duke sqaruar ndër të tjera se: “...shpallja e njoftimit për vendin e lirë të punës në kategorinë Lektor mbështetet në ligjin nr. 80/2015 ‘Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë’. Konkretisht:

- tek neni 3, pika 1, ku thuhet shprehimisht se: ‘Institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi’.
- tek neni 3, pika 3, germa ç, i cili thotë qartas se: 3. Autonomia financiare garantohet nëpërmjet së drejtës:...ç) për të përcaktuar në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij, si dhe për të përcaktuar pagat e personelit, në përputhje me formën e institucionit.
- tek neni 59 ‘Kategoritë e personelit akademik’, pika 2, ku përcaktohet qartë kategorizimi i personelit akademik, në përputhje me rolin e veprimtarinë e tij: ‘2. Personeli akademik mund të jetë me orientim mësimor dhe/ose kërkimor-shkencor. Personeli akademik në institucionet e arsimit të lartë, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në: a) profesorë; b) lektorë; c) asistent-lektorë’”.
- dhe pika 4, ku tregohet qartë se cilët anëtarë të personelit akademik përfshihen në kategorinë ‘Lektorë’.
- tek pika 1 e nenin 64 ‘Punësimi i personelit akademik’, ku thuhet se: ‘1. Kriteret në institucionet publike të arsimit të lartë drejtohet nga një komision ad hoc, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë bazë përkatëse. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit ad hoc, si edhe të përzgjedhjes së personelit akademik caktohen në statutin e IAL-së...’

Së dyti, çmojmë se nuk përbën assesi një rast diskriminimi (jo më të një diskriminimi arsimor, siç pretendohet nga ankuesi), aq sa të kërkojë ndërhyrjen tuaj, por është një çështje e thjeshtë e kthyer në kalë beteje në ankesat e vazhdueshme të bëra nga Prof. Dr. R. G. në institucione të ndryshme, për shkak ndoshta të perceptimit dhe interpretimit të gabuar të dispozitave të ligjit 80/2015, datë 22.07.2015 ‘Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë’. E thënë më saktë, të perceptimit dhe interpretimit të gabuar të nenit 59 të ligjit 80/2015, si dhe të nenit 66 të Statutit të UT.

⁴ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 1322/ prot., datë 26.11.2019

Së treti, na lejoni t'iu shpjegojmë kuintesencën e kësaj çështje, që s'është tjetër veçse pamundësia ligjore e subjektit ankues për të konkuruar dhe, si rrjedhojë, për të pasur mundësinë që të shpallej fitues. ... Fatkeqësisht, Prof. Dr. R. G. nuk e ka të qartë thelbin e ligjit dhe as sot e kësaj dite s'ka arritur të kujtojë që në atë konkurs mund të shprehin interesin për pjesëmarrje vetëm personat që kanë kryer studimet deri në nivelin e doktoraturës, pra që janë pajisur me gradën shkencore 'Doktor', të cilët neni 59 i ligjit i përfshin në kategorinë 'Lektor'. Çdokush që lexon ligjin mund të kuptojë lehtësisht se cilët përfshihen në kategorinë lektor, si dhe në cilën kategori përfshihen personat që kanë fituar titullin akademik 'Prof. Dr.'...Pra, që në fillim ankuesi ka pasur pengesë ligjore për të konkuruar në kategorinë 'Lektor', për të cilën u zhvillua konkursi. Në këto kushte, e vetmja mundësi që në një konkurs për një vend pune në kategorinë 'Lektor', të dalë fitues një person i cili në kuptim të ligjit i përket kategorisë 'Profesor', është që komisioni ad hoc të shkelë ligjin 80/2015. Nga ana tjetër nuk tregon se kemi të bëjmë me një rast diskriminimi fakti që ka dorëzuar dokumentacionin për pjesëmarrje dhe nuk është shpallur fitues, përkundrazi! Për më tepër, ka qënë këmbëngulja e tij për të konkuruar me çdo kusht, me pretendimin për të marrë një të drejtë të cilën ai mendonte se e meritonte, ndonëse i është bërë e qartë se ky konkurs zhvillohet për një kategori të personelit akademik që nuk përfshin mbajtësit e titullit akademik 'Prof. Dr.'... Në gjykimin dhe bindjen tonë, jo vetëm që s'kemi të bëjmë me diskriminim për shkak të gjendjes arsimore, por fakti që ankuesi është lënë të konkurojë fshin çdo lloj dileme në këtë kuptim. Kësisoj, gjykojmë se për nisjen e një procedure administrative, në kuptim të pikës 3 të nenit 32, të ligjit nr. 10221/2010 'Për mbrojtjen nga diskriminimi' dhe pikës 1 të nenit 82 të Kodit të procedurave Administrative, pala që ka iniciuar procedurën, pra R. G., ka barrën e provës për faktet e pretenduara. Duke qënë se në konkursin objekt diskutimi nuk bëhet fjalë për diskriminim, pasi nuk ka seesi të diskriminohet dikush që nuk legjitimohet për të qënë pjesë e procesit konkurrues, është e lehtë të deduktohet edhe fakti që ankuesi s'mund të ketë paraqitur asnjë provë për të mbështetur ankuzën e tij absurde dhe në kuptim të pikës 4, germa 'ç' të nenit 33 të ligjit nr. 10221/2010 kjo ankesë është e papranueshme...Për më tepër, meqë aq gjatë është marrë me kriteret në ankesën e tij, sqarojmë se edhe në rastin hipotetik që ankuesi të legjitimohej për të konkuruar në kategorinë 'Lektor', skualifikimi i tij do të bëhej qysh në fazën e parë të vlerësimit të dosjes, ku bëhet gjykimi nëse konkurenti përmbush kushtin që ciklin e parë të studimeve ta kishte kryer në degën Histori pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë të UT-së, ose në Drejtësi, në Fakultetin e Drejtësisë së UT, çka do të ishte shkak skualifikues, i cili, njëkohësisht, bën që kriteret e tjera të ishin të parëndësishme në fazën e vlerësimit të dosjes. Duke qënë se ankuesi kapet pas pandehmës që kriteret janë diskriminuese, së pari, lind pyetja: përse konkurroi, kur në gjykimin e tij kriteret paskan qënë diskriminuese? Nga ana tjetër, duke lënë në heshtje faktin që ankuesi nuk legjitimohej për të konkuruar, për çka nuk duhej të konkuronte, pasi përfundimi negativ ishte i paracaktuar nga kuptimi i dispozitave ligjore, përkatësisht neni 59 i ligjit nr. 85/2015... Sa për kërkesën e ankuesit për 'pezullimin e efekteve të kontratës së punës mes Universitetit të Tiranës dhe kandidatës fituese', është me vend të themi se, tani që ka mbaruar konkursi, është

bërë shpallja në përputhje me dispozitat përkatëse dhe është bërë i njohur botërisht fituesi i konkursit, askush s'mund t'ia mohojë ankuesit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës...

Po ashtu, kërkesa e tij që 'të shqyrtohet mundësia për të vlerësuar nëse në marrjen e këtij vendimi ka pasur arsye të paragjyqimeve të prejardhjes krahinore dhe përkatësisë politike', është pak të thuhet se qëndron në kufijtë e groteskes. Është një kërkesë që pashmangshmërisht bën të lindin disa pyetje:

- *Në cilin kriter të publikuar në Buletinin nr. 20 të APP-së, është shkruar nëse kandidati duhet të jetë apo duhet të mos jetë nga një ose disa krahina të caktuara?!*
- *Në cilën fazë të konkurimit i është thënë se ai nuk kualifikohet për shkak se është, apo nuk është nga një krahinë e caktuar?!*
- *Në cilin kriter të publikuar në Buletinin nr. 20 të APP-së, është shkruar nëse kandidati duhet të ketë apo duhet të mos ketë përkatësi të caktuar politike?!*
- *Në cilën fazë të konkurimit i është thënë se ai nuk kualifikohet për shkak se ka, apo nuk ka një bindje të caktuar politike?!*
- *Ç'lidhje ka vlerësimi mbi bazën e aftësisë profesionale, me paragjykimin mbi prejardhjen krahinore?*
- *Ç'lidhje ka vlerësimi mbi bazën e aftësisë profesionale, me paragjykimin mbi përkatësinë politike?"*

Kur ka vlerësuar dosjen, komisioni, është kufizuar, fillimisht (në rastin e ankuesit është vendi të thuhet përfundimisht) tek fakti nëse konkurenti i përmbush kriteret e nenit 59 të ligjit nr. 85/2015 lidhur me kategorinë për të cilën zhvillohet konkursi dhe nuk i ka interesuar se në cilin fshat, qytet dhe krahinë ka lindur apo e ka origjinën aplikanti. Po se ç'bindje politike ka aplikanti për çfarë i intereson komisionit?"

Në përfundim të përgjigjes, është vënë në dispozicion të KMD-së:

- Vendimin Nr. 39, datë 24.06.2019 për ngritjen e Komisionit Ad-Hoc për vlerësimin e kandidatëve.
- Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhrin nr. 233, datë 10.12.2019 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, "Për kryerjen e inspektimit pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë së Universitetit të Tiranës, me qëllim marrjen e informacionit, lidhur me ankesën e shtetasit R. G.", inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, më datë 16.12.2019, për të marrë informacion dhe për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Gjatë inspektimit të kryer, inspektorët e KMD-së morën takim me përfaqësuesit e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë (në vijim FHF), me znj. E. H., me detyrë Përgjegjëse e Njësisë Bazë (Departamentit të Historisë) dhe znj. E. K., me detyrë Kryetare e Zyrës së Burimeve Njerëzore të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë.

Fillimisht, sipas përfaqësuesve të FHF-së, ligji nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, e ka të përcaktuar qartë se një pedagog me titullin akademik Profesor-Doktor, nuk mund të zhvillojë seminare. Në rastin konkret, nga Universiteti i Tiranës kishte shpallur njoftimin për vendin e lirë të punës në kategorinë Lektor, i cili do të zhvillonte seminarët e lëndëve: Historia e Marrëdhënieve Ndërkombëtare; Legjislacion Arkivor; Historia e Institucioneve Politike në Evropë; Roli i Arkivave në të Drejtat e njeriut dhe të Drejtat Sociale dhe në Debatet në Kujtesën Historike; Histori e Institucioneve. Kërkesa për shpalljen e pozicionit të kategorisë Lektor, erdhi si rezultat i largimit të dy pedagogëve të Masterit të Arkivistikës dhe mbingarkesës së profesorëve aktual të këtyre lëndëve.

Sa i përket arsyes së vendosjes së kriterit të parë: *“Të jetë diplomuar në ciklin e parë të studimeve bachelor në degën Histori pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë të UT, ose në Drejtësi, në Fakultetin e Drejtësisë të UT”*, nga ana e përfaqësuesve të FHF-së u sqarua se ky kriter u vendos për shkak se zakonisht nga ana e tyre është preferuar që kandidatët të jenë ish-studentë të Universitetit të Tiranës apo të FHF-së. E njëjta procedurë vlerësimi dhe i njëjti vlerësim, si në rastin e ankuesit, është ndjekur edhe për kandidatët e tjerë, të cilët edhe pse nuk e kanë plotësuar kriterin e parë kanë kaluar në fazën e II-të të konkurimit, të intervistës me gojë. Pra, edhe dy kandidatët e tjerë, të cilët nuk kanë përfunduar studimet në UT nuk janë shpallur fitues.

Sipas tyre, një fakt tjetër lidhur me arsyet e skualifikimit të R. G., ka qënë edhe pamundësia financiare e FHF-së, për të paguar një kandidat me titull Profesor-Doktor. Kriteret e pozicionit vakant janë shpallur nga UT, që më datë 20.05.2019 në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe sipas tyre, që nga ai moment kandidatët kanë patur mundësinë t'i ankimonin. Në momentin që kandidatët kanë marrë pjesë në konkurim, kanë pranuar kriteret e vendosura. Që nga data e publikimit, kandidatët kanë patur 30 ditë kohë për kundërshtimin e tyre, por kjo nuk ka ndodhur për asnjë nga kandidatët.

Në përfundim të inspektimit të kryer, nga ana e përfaqësuesve të FHF-së vu në dispozicion një pjesë e provave të kërkuara nga KMD. Sa i përket kopjes së dosjeve të kandidatëve të tjerë me të cilët ka konkuruar R. G., nga ana e FHF-së nuk u dha asnjë kopje e dokumentacionit.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së R. G., Komisioneri me shkresën Nr. 139 prot., datë 23.01.2020, njoftoi zhvillimin e seancës dëgjimore në datë 31.01.2020 duke kërkuar shpjegime shtesë.

Në përfundim, është kërkuar nga ana e subjekteve ndaj të cilëve është paraqitur ankesa, të vënë në dispozicion të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ditën e zhvillimit të seancës dëgjimore, informacionin lidhur me:

- Kopje të dosjeve apo të dokumentave të dorëzuar nga secili kandidat (4 kandidatët) për vendin e lirë të punës kategoria “Lektor”.

Seanca u zhvillua në datën 31.01.2020, me praninë e palëve: subjektit ankues dhe përfaqësueses⁵ së Universitetit të Tiranës. Pavarësisht se Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë dhe Departamenti i Historisë, morën dijeni mbi njoftimin për seancë dëgjimore, nga ana e tyre nuk u paraqit asnjë përfaqësues.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, u njoftuan palët se seanca dëgjimore do të rregjistrohej dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Në vijim të seancës dëgjimore ankuesi u ndal në dy momente në të cilat ai pretendon se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe diskriminuese. Momenti i parë, lidhet me procedurën e ndjekur, konkursin e zhvilluar, ndërsa momenti i dytë lidhet me hartimin e kriterëve.

Sipas ankuesit, mbajtja e fshehtë dhe jo transparente e notës mesatare të kandidatës fituese, cënon rëndë parimim e transparencës, duke mos zhvilluar një konkurs të drejtë, transparent dhe të paanshëm. Përrjashtimi i tij dhe favorizimi i kandidatës E. K., sipas ankuesit përbën diskriminim pasi promovohet kandidati me gradë me të ulët, dhe përjashtohet kandidati me titullin Profesor. Sipas ankuesit, mungesa e transparencës nga ana e FHF-së, Departamentit të Historisë dhe UT-së, lidhen me faktin se fillimisht ai nuk është njoftuar në kohë nga ana e këtyre strukturave për shpalljen e fituesit, duke i mohuar kështu të drejtën e ankimimit të këtij vendimi. Gjithashtu, disa kohë pas shpalljes së fituesit të konkursit, ai është vënë në dijeni se Universiteti i Tiranës ka konstatuar që procedura e konkurimit është zhvilluar në shkelje të legjislacionit për Arsimin e Lartë. Në këto kushte, pavarësisht se sipas tij duhej përsëritur edhe një herë procesi i konkurimit, nga ana e Komisionit ad hoc nëpërmjet një procesverbali është bërë vetëm intervistimi dhe shpallja e kandidatës fituese.

Sa i përket momentit të dytë, ankuesi pretendon se kriteret e hartuara janë në shkelje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, pasi ato në mënyrë të drejtëpërdrejtë përjashtojnë të gjithë kandidatët të cilët nuk kanë përfunduar studimet e ciklit të parë në Universitetin e Tiranës. Sipas tij, hartimi i kriterëve në këtë formë është bërë në mënyrë që të favorizohet kandidatja fituese. Gjithashtu, ai pretendoi se nga ana e Departamentit të Historisë, si autoriteti i cili ka atributet e

⁵ Shtetasit S. B., me autorizim Nr. 360/1 prot., datë 21.01.2020

hartimit të kriterëve, nuk është realizuar një mbledhje apo nuk ka një procesverbal të protokolluar ku të jenë arsyetuar dhe vendosur kriteret e konkurimit për vendin e punës për pedagog.

Në vijim të seancës, përfaqësuesja e UT-së shtoi se pretendimet e ngritura nga ana e subjektit ankues nuk qëndrojnë, pasi sipas saj Ligji për Arsimin e Lartë ka përcaktuar kompetencën e Njësisë Bazë apo të Departamentit për hartimin e kriterëve për çdo vend pune që hapet për konkurim, në bazë të nevojave që ka. Me nevoja do të kuptohet së pari, përcaktimi i kategorisë së personelit akademik. Në këtë kuadër, nuk mund të pretendohet diskriminim, pasi në rastin konkret FHF ka kërkuar personel akademik të kategorisë Lektor dhe jo me gradë shkencore Profesor.

Nga përfaqësuesja e UT-së u theksua se, Rektori i UT-së, pasi gjeti shkelje në procedurat e ndjekura të konkurimit, që lidhen me kalimin në fazën e intervistimit të kandidatit R. G., për shkak se ai nuk i plotësonte kriteret e përgjithshme, ka kërkuar përsëritjen e tyre. Në vijim, është bërë rivlerësimi i kandidatëve sipas dosjeve, është intervistuar kandidati i cili plotësonte kriteret për fazën tjetër të konkurimit dhe në përfundim është shpallur fituesi. R. G. në rastin konkret nuk është njoftuar më, pasi është konstatuar apo rivlerësuar nga komisioni se nuk plotësonte kriteret e përgjithshme.

Sa i përket faktit pse është kërkuar që në konkurs duhet të marrin pjesë vetëm kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës, në Fakultetet e Histori-Filologjisë apo Drejtësisë, nga ana e përfaqësueses së UT-së u sqarua se ky kriter është vendosur bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit për Arsimin e Lartë. Sipas këtyre parashikimeve ligjore, Institucionet e Arsimit të Lartë kanë autonomi në përzgjedhjen e personelit akademik. Në këtë këndvështrim, Njësia Bazë, referuar politikave që ka institucioni, ka kërkuar që kandidatët të plotësojnë kriterin e sipërcituar. Në këtë rast, institucioni i Rektorit të UT-së ka rënë dakord me kriteret e vendosura dhe i ka miratuar ato. Fakti që nuk mund të pranohet në konkurim një kandidat me titullin profesor për një vend pune ku kërkohet Lektor, lidhet me mbikualifikimin e tij. Kjo, për shkak të attributeve që përfiton kandidati me titull profesor, ngarkesës mësimore, si dhe faktit që ky i fundit në ndryshim nga kandidati Lektor, bëhet titullar lënde.

Në përgjigje të kërkesave të cituara nga Komisioneri në shkresën Nr. 139 prot., datë 23.01.2020, njoftim për seancë dëgjimore, nga ana e subjekteve ndaj të cilëve është paraqitur ankesa, nuk u vu në dispozicion asnjë dokumentacion.

- Pas seancës dëgjimore, me anë të shkresës Nr. 296 prot., datë 19.02.2020, KMD i është drejtuar subjekteve ndaj të cilëve është paraqitur ankesa dhe ka kërkuar informacion, lidhur me:
- Kopje të dosjeve apo të dokumentave të dorëzuar nga secili kandidat (4 kandidatët) për vendin e lirë të punës kategoria “Lektor”.

- Kopje të proceverbalit të mbledhjes apo protokollit të mbledhjes së Departamentit të Historisë, ku janë përcaktuar kriteret e vendosura, për vendin e lirë të punës kategoria “Lektor”.
- Informacion lidhur me arsyet pse është vendosur si kriter që kandidati: *“Të jetë i diplomuar në ciklin e parë të studimeve në degën Histori pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë UT, ose në Drejtësi, në Fakultetin e Drejtësisë të UT –së”*.
- Informacion mbi arsyet pse është kërkuar që kandidatët mund të kenë edhe formimin në drejtësi? Çfarë lëndësh do të zhvillojë kandidati i kualifikuar? Për këtë, të përcaktohet një informacion, sa prej lëndëve i përkasin formimit në drejtësi dhe sa prej lëndëve i përkasin formimit në histori.
- Informacion mbi arsyet pse është vendosur në kriteret e përgjithshme që kandidatët të kenë përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës?

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, pavarësisht faktit që subjektet ndaj të cilëve është paraqitur ankesa kanë marrë dijeni, nuk kanë vënë në dispozicion të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi asnjë informacion.

Gjatë shqyrtimit të këtij ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje objekt i ankesës dhe që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

LMD⁶ në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”*.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Departamenti i Historisë, së Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, për plotësim të stafit akademik, me shkresën Nr. 360/6 prot., datë 06.05.2019, ka përcjellë pranë Dekanit, Kriteret për një vend pune *“lektor”*. Në kriteret e përgjithshme të vendosura nga Departamenti i Historisë, kërkohet që kandidati konkurent:

- Të jetë i diplomuar (bachelor), në Degën Histori, pranë Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë (UT) ose Drejtësi, pranë Fakultetit të Drejtësisë (UT).
- Të ketë notë mesatare të studimeve universitare (bachelor) mbi 9 (nëntë).
- Të ketë kryer studimet post universitare, Master i Shkencave ose studime ekuivalente me këtë nivel, në drejtimit *“Marrëdhënie Ndërkombëtare”*, ose *“E Drejtë Ndërkombëtare Publike”*.
- Të ketë notë mesatare të studimeve post universitare Master i Shkencave (ose ekuivalente me të), 9 (nëntë) e lartë.
- Të ketë së paku 3 vite përvojë pune të dokumentuar në mësimdhënie në fushat e sipërsënuara (jurisprudencë, marrëdhënie ndërkombëtare, histori) në universitet, para ose pas fitimit të gradës shkencore *“Doktor i Shkencave”*.
- Të ketë mbrojtur gradën shkencore *“Doktor i Shkencave”*, me rezultate shumë të larta (mbi 90 pikë) në fushën e historisë, ose të marrëdhënies ndërkombëtare.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga Gjykatat në Shqipëri apo edhe në vende të tjera.
- Të mos jetë marrë ndaj saj/tij, masë disiplinore e largimit nga puna.

Në kriteret e veçanta të vendosura nga Departamenti i Historisë, kërkohet që kandidati konkurent:

- Të ketë formim akademik në fushën e tranzicionit, historisë së Shqipërisë, marrëdhënies ndërkombëtare, dhe në fushën e së drejtës ndërkombëtare publike.
- Të ketë botime (tre vitet e fundit), artikuj dhe referime në konferenca shkencore (kombëtare dhe ndërkombëtare), në fushën e historisë dhe të së drejtës, brenda dhe jashtë vendit.

Me shkresën Nr. 360/7 prot., datë 06.05.2019, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë ka ridërguar kriteret e punësimit për personel akademik pranë Rektorit të Universitetit të Tiranës. Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Rektori i Universitetit të Tiranës me anë të shkresës Nr. 1678/7 prot., datë 21.05.2019, ka informuar Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, lidhur me Vendimin e

⁶ Shkurtesë e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Rektorit nr. 67, datë 13.05.2019 dhe përcjelljen e tij me anë të shkresës nr. 1678/6 prot., datë 16.05.2019, për publikim në Agjencinë e Prokurimeve Publike (në vijim APP).

Referuar njoftimit të bërë në faqen e APP nr. 20, datë 20.05.2019, është shpallur konkursi për 1(një) vend të lirë pune për personel akademik në Departamentin e Historisë, në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, Kategoria “*Lektor*”.

Njoftimi ka të specifikuar kërkesat që kandidatët duhet të plotësojnë për këtë pozicion pune, në kritere të përgjithshme dhe kritere të veçanta. Kështu, në mënyrë të detajuar janë përcaktuar:

- Kandidatët për vendin e punës për personel akademik në **Departamentin e Historisë**, grupi mësimor, **Kategori “*Lektor*”**, duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme:
 1. Të jetë diplomuar në ciklin e parë të studimeve bachelor në degën Histori pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë të UT, ose në Drejtësi, në Fakultetin e Drejtësisë të UT.
 2. Të ketë notë mesatare të studimeve të ciklit të parë bachelor mbi 9.
 3. Të jetë diplomuar në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave ose diploma ekuivalente me to, në drejtimet “*Marrëdhënie Ndërkombëtare*” ose “*E Drejtë Ndërkombëtare Publike*”.
 4. Të ketë notë mesatare të studimeve Master i Shkencave (ose diplomat ekuivalente me to), 9 e lart.
 5. Të ketë së paku tri vite përvojë të dokumentuar në mësimdhënie në fushat e sipërcituara (jurisprudencë, marrëdhënie ndërkombëtare, histori), në universitet, para ose pas fitimit të gradës shkencore “*Doktor*”.
 6. Të ketë mbrojtur gradën shkencore “*Doktor*” me rezultate shumë të larta (mbi 90 pikë) në fushën e historisë ose të marrëdhënieve ndërkombëtare.
 7. Të zotërojnë me dëshmi së paku një gjuhë të huaj perëndimore.
 8. Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.
 9. Të mos jetë marrë ndaj tij masa disiplinore e pushimit nga puna.
- Kandidatët konkurentë për këtë vend pune, preferohet të plotësojnë edhe këto **kritere të veçanta**:
 1. Të ketë formim akademik në fushën e tranzicionit, historisë së Shqipërisë, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe në fushën e së drejtës ndërkombëtare publike.
 2. Të ketë botime (tre vitet e fundit), artikuj, referime në konferencën shkencore (kombëtare dhe ndërkombëtare) në fushën e historisë dhe të së drejtës, brenda dhe jashtë vendit.

R. G., pasi është vënë në dijeni të këtij njoftimi të publikuar në Buletinin e Prokurimeve Publike, më datë 03.06.2019 ka paraqitur aplikimin e tij, pranë zyrës së Burimeve Njerëzore të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë.

Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 64, pikën 1 të tij, ka parashikuar se: *“Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësisia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit, dhe miratohen nga rektori. Konkursi në institucionet publike të arsimit të lartë drejtohet nga një komision Ad-Hoc, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë bazë përkatëse. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit Ad-Hoc, si dhe të përzgjedhjes së personelit akademik caktohen në statutin e IAL-së”*.

Përsa në sipër dhe në vijim të procedurës, me Vendim të Dekanit të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë nr. 39, datë 24.06.2019, është ngritur Komisioni Ad-hoc për konkursin personell akademik të kategorisë “Lektor”, në Departamentin e Historisë.

Nga Procesverbali i Komisionit Ad-hoc, mbajtur më datë 03.07.2019, rezulton se në konkurim për vendin e lirë punës për personell akademik në Departamentin e Historisë, në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, Kategoria “Lektor”, kanë qënë 4 (katër) kandidat, përkatësisht:

- **Prof. Dr. R. G.**
- Dr. E. Gj.
- Dr. J. C.
- **Dr. E. K.**

Referuar Procesverbalit të sipërcituar, katër kandidatët janë intervistuar nga ana e Komisionit Ad-hoc dhe më pas është vendosur që kandidaturat që duhen marrë në konsideratë dhe që do të shqyrtohen për votim, janë Prof. Dr. R. G. dhe Dr. E. K. Në përfundim të procedurës së konkurimit, Komisioni Ad-hoc ka shpallur fitues kandidaten E. K.

Sipas informacionit të administruar nga palët, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, me anë të shkresës Nr. 360/9 prot., datë 05.07.2019, ka përcjellë pranë Rektorit të UT-së dokumentacionin mbi rezultatet e konkursit për kategorinë “Lektor” të Departamentit të Historisë, për ndjekjen e procedurave të mëtejshme. Pas analizës së bërë, Universiteti i Tiranës, ka konstatuar faktin që procedura e ndjekur nga ana e Komisionit Ad-hoc nuk është zhvilluar konform nenit 67, pika 7 të Statutit të Universitetit të Tiranës. Për këtë arsye, me anë të shkresës Nr. 1678/12 prot., datë 11.07.2019, Rektori i UT-së ka kërkuar nga ana e Komisionit Ad-hoc të bëhen edhe një herë procedura për përzgjedhjen e kandidatit fitues për këtë vend pune, në zbatim të Statutit të UT-së.

Statuti i UT-së, në nenin 67, pika 7 të tij, parashikon se: *“Komisioni, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, por jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimin të tyre, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim. Vlerësimi i kandidaturave përfshin dy faza të njëpasnjëshme, që janë vlerësimi i dosjes dhe intervista. Vetëm kandidatët e kualifikuar nga*

faza e shqyrtimit të dosjeve i nënshtrohen intervistës. Komisioni, brenda tri ditëve pune nga dita e zhvillimit të intervistës, shpall kandidatin/kandidatët fitues. Konkurrimi zhvillohet në mjediset e njësisë kryesore ku edhe shpallen kandidatët fitues, shoqëruar dhe me publikimin në faqen zyrtare të njësisë kryesore.”

Sipas vlerësimit të Rektorit të UT-së dhe mbështetur në parashikimet e Statutit të USH-së, Komisioni Ad-hoc, duhet të kishte kaluar në fazën e intervistimit vetëm kandidatët e kualifikuar nga faza e shqyrtimit të dosjeve dhe jo të gjithë kandidatët.

Përsa më sipër, më datë 15.07.2019, Komisioni Ad-hoc është mbledhur sërish për të bërë vlerësimin e dosjeve të kandidatëve konkurues për vendin vakant, personel akademik të kategorisë “Lektor”. Pas shqyrtimit të dosjeve të secilit kandidat pjesëmarrës në konkurim, komisioni ka vendosur të kalojë në fazën e dytë, atë të intervistimit vetëm kandidaten E. K. dhe ta shpallë fituese. Këtë vendim, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë e ka përcjellë pranë Universitetit të Tiranës për kryerjen e procedurave të mëtejshme me anë të shkresës Nr. 360/11 prot., datë 16.07.2019.

Referuar nenit 67, pika 8 e Statutit të UT-së, ku sanksionohet se: “8. Komisioni ad hoc i paraqet kandidatin/kandidatët fitues Rektorit të UT-së përmes drejtuesit të njësisë kryesore. Rektori, brenda 10 ditëve nga shpallja e kandidatit/kandidatëve fitues, nënshkruan kontratën e punës me të/ta dhe nga ky moment fillojnë marrëdhëniet e punës”, Rektori i UT-së me shkresën Nr. 1678/15 prot., datë 19.07.2019, ka përcjellë pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë Vendimin Nr. 117, datë 19.07.2019 “Për emërimin me kontratë pune me afat të pacaktuar të personelit akademik të kategorisë Lektor në Departamentin e Historisë dhe Filologjisë së UT-së”.

Nga informacioni i administruar, nuk është vënë në dispozicion të Komisionerit asnjë dokumentacion lidhur me njoftimin e kandidatëve për ribërjen e procedurave të konkurimit për vendin vakant, personel akademik të kategorisë “Lektor”, në Departamentin e Historisë.

Lidhur me sa mësipër, në kontekst të përmbushjes dhe plotësimit të kriterëve të përcaktuara, Komisioneri konstaton se:

- Lidhur me kriteret e përgjithshme:

Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 64, pikën 1 të tij, ka parashikuar se: “Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësi bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit, dhe miratohen nga rektori. Konkursi në institucionet publike të arsimit të lartë drejtohet nga një komision Ad-Hoc, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë bazë përkatëse.

Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit Ad-Hoc, si dhe të përzgjedhjes së personelit akademik caktohen në statutin e IAL-së”.

Statuti i UT-së, në Nenin 67 të tij parashikon në mënyrë të detajuar procedurat e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë, si dhe kriteret e përgjithshme në procedurën e konkurimit. Sipas parashikimeve të sanksionuara në këtë nen, në pikën 1 dhe 2 të tij citohet se: *“1. Punësimi realizohet me procedurë të konkurrimit të hapur përmes një procesi transparent, të paanshëm dhe objektiv. 2. Kandidatët duhet të plotësojnë këto kriteret të përgjithshme: a) Të kenë zotësi të plotë për të vepruar; b) Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurrojnë; c) Të kenë përfunduar studimet master shkencor dhe/ose studime të doktoratës në të njëjtën fushë; d) Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje; e) Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.”*

Në zbatim të sa mësipër, Departamenti i Historisë ka vlerësuar vendosjen e kriterëve, të ndara konkretisht në kriteret të përgjithshme dhe në kriteret specifike. Në rastin konkret Departamenti i Historisë dhe Filologjisë ka miratuar si kriter të parë të përgjithshëm kërkesën që kandidati: *“Të jetë diplomuar në ciklin e parë të studimeve bachelor në degën Histori pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë të UT, ose në Drejtësi, në Fakultetin e Drejtësisë të UT.”*

Së pari, mbështetur në provat e administruara, Departamenti i Historisë, nuk ka vënë në dispozicion të Komisionerit asnjë akt, procesverbal apo dokumentacion tjetër, në të cilin të citohen arsyet të cilat kanë çuar në vendosjen e kriterit që kandidati të jetë diplomuar në ciklin e parë të studimeve bachelor në degën Histori pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë të UT, ose në Drejtësi, në Fakultetin e Drejtësisë të UT. Pavarësisht kësaj dhe referuar këtij parashikimi, Departamenti i Historisë nëpërmjet vendosjes së këtij kriteri ka përjashtuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë të gjithë kandidatët që nuk kanë përfunduar studimet bachelor në degën Histori pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë të UT-së, ose në Drejtësi, në Fakultetin e Drejtësisë të UT-së. **Gjithashtu, edhe pse ankuesi disponon dy diploma të ciklit të parë të studimeve në Universitetin e Shkodrës, një në Fakultetin e Drejtësisë dhe një në Fakultetin e Histori-Gjeografisë, në mënyrë të drejtëpërdrejtë është përjashtuar nga konkurimi për vendin vakant në Departamentin e Historisë, duke u trajtuar kështu në mënyrë të padrejtë dhe të pabarabartë në krahasim me kandidatën fituese.**

Së dyti, kriteri i dytë i vendosur për kandidatët, të cilët duhet të kenë notë mesatare të studimeve të ciklit të parë bachelor mbi 9, në pamje të parë nuk e vendos ankuesin në kushte të pabarabarta apo të padrejta, por analizuar kjo në vijim të kriterit të parë, e përjashton në mënyrë të drejtëpërdrejtë ankuesin, pavarësisht se ai ka notën mesatare 9.9 të ciklit të parë të studimeve në Fakultetin e Histori-Gjeografisë të Universitetit të Shkodrës.

Duke i marrë së bashku këto kritere, në raport me kandidaten fituese, subjekti ankues është vënë në pozita të pabarabarta dhe të padrejta nga ana e Departamentit të Historisë si hartues i këtyre kritereve, si dhe nga ana e Universitetit të Tiranës, si miratues të tyre.

Së treti, në njoftimin për shpalljen e konkursit për vend të lirë pune, për personel akademik në Departamentin e Historisë, në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, kategoria “Lektor”, nuk rezulton të jetë përcaktuar grup lëndë për të cilën kërkohet të angazhohet personeli akademik. Kriteri i tretë i vendosur i cili kërkon që kandidati të jetë diplomuar në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave ose diploma ekuivalente me to, në drejtimet “Marrëdhënie Ndërkombëtare” ose “E Drejtë Ndërkombëtare Publike”. Lidhur me këtë fakt, Komisioneri vlerëson se, mospërcaktimi i fushës/grup lëndëve për personelin akademik që do të angazhohet me kohë të plotë, sjell pabarazi në vlerësimin e aplikantëve/kandidatëve, referuar këtij kriteri. Në këtë kuptim, nuk është dhënë një justifikim i arsyeshëm dhe proporcional lidhur me përcaktimin e kriterit të parë dhe të tretë.

Në përfundim të arsytimit, ankuesi është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të padrejtë në krahasim me kandidaten fituese, pasi është përjashtuar për shkak se nuk ka përfunduar ciklin e parë të studimeve në një nga degët e kërkuara në Universitetin e Tiranës. Nga analiza e bërë informacionit të dhënë nga palët, edhe dy kandidatët e tjerë nuk kanë përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës, por në çdo rast ata do të përjashtoheshin nga konkurimi për shkak se nuk plotësonin kriterin e notës mesatare.

- Lidhur me skualifikimin e R. G. për shkak se mbante titullin shkencor “Profesor”:

Në nenin 59 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohen kategoritë e personelit akademik dhe citohet se: “1. Personeli akademik në institucionet e arsimit të lartë kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të institucionit të arsimit të lartë, këshillim për studentët si dhe veprimtari të tjera. 2. Personeli akademik mund të jetë me orientim mësimor dhe/ose kërkimor-shkencor. Personeli akademik në institucionet e arsimit të lartë, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në: a) profesorë; b) lektorë; c) asistent-lektorë. 3. Në kategorinë “Profesorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie mbajnë titujt akademikë “Profesor” ose “Profesor i asociuar”. Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar. 4. Në kategorinë “Lektorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik, që zhvillojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore-shkencore. Në këtë kategori përfshihen anëtarët e personelit akademik që mbajnë gradën shkencore “Doktor”, kanë së paku tre vite eksperiencë në mësimdhënie para ose pas fitimit të kësaj grade dhe përmbushin kriteret e përcaktuara në statutin e institucionit të arsimit të lartë. Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar...”

Në nenin 3, të ligjit të sipërcituar thuhet shprehimisht se: *“1. Institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi...3. Autonomia financiare garantohet nëpërmjet së drejtës: ...ç) për të përcaktuar tarifën e studimit, në përputhje me këtë ligj; d) për të administruar pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që institucionet zotërojnë ligjërisht, në përputhje me misionin e tyre.”*

Përsa më sipër, Komisioneri vlerëson se në nuk ekziston asnjë kufizim ligjor i cili të pengojë një kandidat i cili mban titullin shkencor “Profesor”, për të konkuruar për vendin e lirë të punës së publikuar nga ana e Departamentit të Historisë.

Gjatë procedurës së konkurimit për vendin vakant në Departamentin e Historisë, për asnjë moment, ankuesi nuk është përjashtuar për shkak se ishte i mbikualifikuar siç është shprehur edhe përfaqësuesja e Universitetit të Tiranës gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar më datë 31.01.2020.

Në kontekst të analizimit të gjithë fakteve sipër përmendur, veçmas dhe bashkarisht, Komisioneri vlerëson se, ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pabarabartë në raport me kandidaten e shpallur fituese, në dy momente. Momenti i parë lidhet me hartimin dhe shpalljen e kriterëve të konkursit të zhvilluar, ndërsa momenti i dytë lidhet me procedurën e ndjekur nga ana e strukturave të Departamentit të Historisë dhe Komisionit Ad hoc.

Përsa më sipër dhe referuar nenit 64, pika 1 të Ligjit nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësi bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit, dhe miratohen nga rektori. Në këtë kuptim, ankuesi është vënë në pozita të pabarabarta dhe të padrejta në raport me kandidaten fituese, që në momentin e hartimit të kriterëve të përcaktuara nga Departamenti i Historisë dhe deri në momentin e miratimit nga ana e Rektorit të UT-së.

Në vijim dispozita e sipërcituar, përcakton se, konkursi në institucionet publike të arsimit të lartë drejtohet nga një komision Ad-Hoc, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë bazë përkatëse. Në këtë kuptim, duke qënë se Komisioni Ad hoc, është përgjegjës për zhvillimin e procedurave të konkurimit, ka vënë ankuesin në pozita të pabarabarta dhe të padrejta në raport me kandidaten fituese, në momentin që kanë përsëritur procedurën e konkurimit dhe nuk e kanë njoftuar atë, por kanë njoftuar vetëm kandidaten fituese.

Neni 14, pika 5/k⁷, neni 47, pika 1/a⁸ dhe neni 67, përcaktojnë në mënyrë të qartë, kompetencën e secilës strukturë në organizimin e procesit të konkurimit për personel akademik në Universitetin e Tiranës. Në këtë kuptim, konstatohet se përgjegjës kryesor në miratimin e kriterëve, kandidatit fitues dhe shpalljes së tij, në konkurset që zhvillohen për personel akademik janë strukturat e Rektoratit të UT-së, ndërsa Departamentet dhe Komisionet e ngritura Ad hoc, janë përgjegjës për hartimin e kriterëve dhe organizimin e procedurës së konkurimit për personel akademik. Referuar përcaktimeve në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutin e UT-së, Fakulteti është struktura e cila i paraqet kandidatin/kandidatët fitues Rektorit të UT-së. Në këtë kuptim, njësia kryesore apo në rastin konkret, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, nuk ka përgjegjësi në miratimin e kriterëve, shpalljen e tyre apo të kandidatit fitues.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se, subjekti ankues, në referencë të nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është ekspozuar haptazi para një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë, krahasuar me kandidaturën e znj. E. K, në hartimin dhe miratimin e kriterëve të konkurimit nga ana e Departamentit të Historisë dhe Rektori i UT-së, si dhe në zhvillimin e procedurës së konkurimit nga ana e Komisionit Ad hoc.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2⁹, të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që perfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me parashikimet ligjore, në kushtet kur mungon krahasuesi.

⁷I cili parashikon se: “Departamenti ushtron këto kompetenca në fakultete: ...k) Përcakton kriteret e punësimit të personelit akademik dhe atij ndihmësakademik...”

⁸ I cili përcakton se: “Dekani kryen këto funksione: a) Koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve kolegjiale të njësisë kryesore...”

⁹“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b)barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo forme sjelljeje qe nxit diskriminim.”

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Ankuesi ka pretenduar në thelb, trajtim të padrejtë, nga ana e Universitetit të Tiranës, Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, Departamentit të Historisë dhe Komisionit¹⁰ Ad Hoc, për shkak të gjendjes arsimore.

Komisioneri në rastin konkret, me gjendje arsimore kupton faktin që ankuesi disponon një diplomë të nivelit të parë të studimeve në një universitet tjetër dhe jo në Universitetin e Tiranës, siç është përcaktuar në kriteret e punësimit nga ana e Departamentit të Historisë dhe Rektorit të UT-së. Në këtë rast, gjendjen arsimore, Komisioneri e vlerëson si shkak të mbrojtur të LMD-së.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë me shkakun e mbrojtur.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përlligje e arsyeshme për trajtimin ndryshe të evidentuar.

Bazuar në dokumentacionin që disponon nga hetimi, Komisioneri vlerëson se ankuesi mbart shkakun e mbrojtur “gjendja arsimore”.

Lidhur me sa më lart, Komisioneri ka vlerësuar se ankuesi është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë, krahasuar me kandidaturën e znj. E. K, nga ana e Universitetit të Tiranës, Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, Departamentit të Historisë dhe Komisionit Ad Hoc.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit “*Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional*”. Dispozita kushtetuese i garanton çdo personi të drejtën për punë.

¹⁰ Shtetasve: P. N., M. Gj., E. H., E. B. dhe Ç. D.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Neni 14 i Konventës garanton barazinë “në gëzimin e të drejtave dhe lirive” të përcaktuara në të. Protokolli 12-të i saj ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe në fushëveprimin e tij sesa Neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.¹¹

Karta Social Europiane¹² parashikon si detyrim të të gjithë vendeve nënshkruese përmbushjen dhe zbatimin e disa parimeve. Në pjesën e parë të kësaj Karte parashikohet: *“Palët pranojnë si synim të politikës së tyre, që do të ndiqet me të gjitha mjetet e përshtatshme, si të karakterit kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar, arritjen e kushteve në të cilat të drejtat dhe parimet e mëposhtme mund të realizohen në mënyrë efektive: Cilido do të ketë mundësinë të fitojë jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht.”*

Në vijim, në nenin 1 të Kartës sanksionohet e drejta për punë dhe në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane parashikohet shprehimisht: *“Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Karte do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkaku të tillë si racë, ngjyrë, seksi, gjuhë, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjine shoqërore, shëndeti, shoqërizimi me një minoritet kombëtar, lindjeje ose statusi tjetër”.*

Mbrojtjen e parimit të mosdiskriminimit në marrëdhëniet e punës e gjejmë të parashikuar edhe në Direktivën e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për *“Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”*, ku në interpretim të zgjeruar të saj, ndër të tjera përfshihet edhe mbrojtja nga diskriminimi për shkakun e sipërcituar¹³.

Duke vijuar më tej, legjislacioni shqiptar e ka përforcuar mbrojtjen nga diskriminimi edhe nëpërmjet parashikimeve me karakter antidiskriminues në akte të tjera, ligjore. Neni 9, i Kodit të

¹¹ https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discr_law_SQI.pdf, faqet 47 dhe 49

¹² Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

¹³ Fq 8-9 e vendimit.

Punës¹⁴, parashikon se: “Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohej çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me Hiv/Aids, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.”

Ky parashikim është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së. Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim.

Ligji nr. 10 221/2010 “Per Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 12, pika 1, geramat a), b), parashikon se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve”.

Kodi i Procedurës Administrative¹⁵, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast strukturave të Universitetit të Tiranës, Departamentit të Historisë dhe Komisionit Ad hoc, të cilët duhet të provonin se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar prej tij.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur

¹⁴ Përafruar pjesërisht me:

Direktivën e Këshillit 91/533/KEE, datë 14 tetor 1991, “Mbi detyrimin e punëdhënësit për të informuar punonjësit për kushtet e zbatueshme në kontratë ose në marrëdhënien e punësimit”. Numri CELEX 31991L0533, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 288, dt. 18. 10. 1991, f. 32 – 35.

Direktivën e Këshillit 2000/78/KE, datë 27 nëntor 2000, “Mbi krijimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion”. Numri CELEX 32000L0078, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 303, dt. 2. 12. 2000, f. 16-22.

Direktivën 2006/54/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 5 korrik 2006, “Mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit”. Numri CELEX 32006L0054, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 204, dt. 26. 7. 2006, f. 23-36.

¹⁵Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej tij”.

diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Parimi i ndarjes së barrës së provës është ngulitur mirë tashmë në ligjin e BE dhe KEDNJ. KEDS¹⁶ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të duhur.

Sa më sipër, për shkak se subjekti kundër të cilit pretendohet diskriminim posedon informacionin e nevojshëm, për të provuar të kundërtën ligji i mosdiskriminimit lejon që barra e provës të ndahet me këtë subjekt (zhvendosja e barrës së provës). Pasi personi që pretendon diskriminim krijon një prezumim të diskriminimit (diskriminimi prima facie), barra më pas kalon tek subjekti, i cili duhet të tregojë se **ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues**. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse diskriminuesi i pretenduar nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.¹⁷

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjektet kundër të cilëve është bërë ankesa të vihen në dijeni dhe i janë ofruar mundësitë që të japin shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Në kuptim përse më sipër, Komisioneri ka konstatuar se:

- Nga informacioni i administruar, nuk është vënë në dispozicion të Komisionerit asnjë dokumentacion lidhur me njoftimin e kandidatëve për ribërjen e procedurave të konkurimit për vendin vakant, personel akademik të kategorisë “Lektor”, në Departamentin e Historisë.

¹⁶ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

¹⁷ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

- Gjatë procedurës së konkurimit për vendin vakant në Departamentin e Historisë, për asnjë moment, ankuesi nuk është përjashtuar për shkak se ishte i mbikualifikuar siç është shprehur edhe përfaqësuesja e Universitetit të Tiranës gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar më datë 31.01.2020, por ai është përjashtuar për shkak se nuk ka patur një diplomë universitare të nivelit të parë të përfunduar në Universitetin e Tiranës.
- Nga ana e Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë nuk u soll asnjë fakt, provë apo shpjegim që të justifikojë vendosja e kriterëve përjashtuese për të gjithë kandidatët e mundshëm, diploma e të cilëve nuk ishte nga UT.

Komisioneri vlerëson se nga ana e Universitetit të Tiranës, Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, Departamentit të Historisë dhe Komisionit Ad Hoc, nuk u arrit të provohej:

1. Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga ankuesi, pra gjendjes arsimore të ankuesit dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë nga ana e Universitetit të Tiranës, Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, Departamentit të Historisë dhe Komisionit Ad Hoc, të konstatuar edhe nga Komisioneri në këtë vendim.
2. Që për veprimet e këtij subjekti kundrejt ankueses ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, pra që këto veprime ndiqnin një synim të ligjshëm dhe masat për arritjen e këtij synimi ishin proporcionale.

Duke analizuar procedurën e ndjekur nga Komisioni Ad hoc për rekrutimin për një vend pune në pozicionin e ‘Lektor’ në Departamentin e Historisë, në Universitetin e Tiranës, rezulton se në bazë të tij, përjashtohen nga konkurimi në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjithë kandidatët¹⁸, përfshirë edhe ankuesin, që nuk janë diplomuar në ciklin e parë të studimeve bachelor në degën Histori pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë të UT, ose në Drejtësi, në Fakultetin e Drejtësisë të UT, duke bërë paragjykes që në fillim gjithë procesin. Ky veprim krijon dyshimin e arsyeshëm që kandidati fitues është paracaktuar nga ana e këtij Komisioni. Në këtë kuptim, Komisioneri konstaton se trajtimi i pafavorshëm dhe i pabarabartë i ankuesit nga ana e Universitetit të Tiranës, Departamentit të Historisë dhe Komisionit Ad Hoc, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me gjendjen arsimore të tij.

Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 64, pikën 1 të tij, ka parashikuar se: *“Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësisia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit, dhe miratohen nga rektori. Konkursi në institucionet publike të arsimit të lartë drejtohet nga një komision Ad-Hoc, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë bazë përkatëse. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit Ad-Hoc, si dhe të përzgjedhjes së personelit akademik caktohen në statutin e IAL-së”*.

¹⁸ Kandidatët që kanë konkuruar, po ashtu edhe ata që “hipotetikiht” mund të kishin konkuruar.

Përsa më sipër, KMD gjykon që praktika e rekrutimit e ndjekur nga UT, që në momentin e hartimit të kriterëve të përcaktuara nga Departamenti i Historisë, miratimit nga ana e Rektorit të UT-së, vendos në pozita diskriminuese ankuesin për shkak se diploma e tij bachelor nuk ishte e UT-së, siç parshikonin kriteret. Gjithashtu, KMD gjeti shkelje në procedurën e rekrutimit të ndjekur nga Komisioni Ad Hoc. Ky Komision i cili është përgjegjës për zhvillimin e procedurave të konkurimit, ka përsëritur procedurën e konkurimit dhe nuk e ka njoftuar ankuesin, por ka njoftuar vetëm kandidatën fituese.

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3, pika 2, parashikon se: *“Diskriminim i drejtëpërdrejtë është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”.*

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ankuesi, diskriminohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë për shkak të gjendjes së tij arsimore përmes vendosjes së kriterit që kandidatët duhet të jenë të diplomuar në ciklin e parë të studimeve bachelor në degën Histori pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë të UT, ose në Drejtësi, në Fakultetin e Drejtësisë të UT, duke sjellë skualifikimin e tij.

Sa i përket pretendimeve të ankuesit për diskriminim lidhur me përkatësinë politike të dhe prejardhjen krahinore, Komisioneri në mungesë të informacionit nga ana e palëve në proces, nuk arrin të konstatojë këtë pretendim të tij.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 9, të Kodit të Punës nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë, për shkak të gjendjes arsimore, në fushën e punësimit, të R. G., nga ana e Universitetit të Tiranës, Departamentit të Historisë dhe Komisionit Ad Hoc.
2. Universiteti i Tiranës dhe Departamenti i Historisë të marrin masat për ndreqjen e pasojave, lidhur me skualifikimin e kandidatit R. G., në konkursin për pozicionin e lektorit të brendshëm pranë Departamentit të Historisë së këtij universiteti, duke përsëritur rishtaz procedurën e punësimit në funksion të gjetjeve të konstatuara në këtë vendim.

3. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Universiteti i Tiranës, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja arsimore)

(Fusha: Punësim)